

CHALLENGES AND ESSENTIALS OF THE E-PROCUREMENT SYSTEM IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Besnik Hajdari

University "Haxhi Zeka" Peja, Faculty of Business, besnik.h.hajdari@outlook.com

Vehbi Ramaj

Faculty of Computer Science, University "Ukshin Hoti" Prizren

Abstract: This paper outlines the readiness for the creation and implementation of electronic procurement where the main focus within this paper is the elaboration of the challenges and shortcomings of the electronic procurement platform in the Republic of Kosovo. The comparative methodology of the description of these domains is derived based on the platform developed by the electronic platform where according to the processes of implementation of information technology can be created after the application and implementation of the final system.

Keywords: Challenges, shortcomings, electronic system, etc.

SFIDAT DHE MANGËSITË E SISTEMIT TË E-PROKURIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Besnik Hajdari

Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Fakulteti i Biznesit, besnik.h.hajdari@outlook.com

Vehbi Ramaj

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Abstrakt: Në këtë punim janë shtjelluar gatishmëria e cila është parashikuar në krijimin dhe zbatimin e prokurimit elektronik ku fokusi kryesor brenda këtij punimi është shtjellimi i sfidave dhe mangësive të platformës së prokurimit elektronik në Republikën e Kosovës.

Metodologjia krahasuese e përshkrimit të këtyre fushave është nxjerrë duke u bazuar në platformën e përgatitur të platformës së sistemit elektronik ku sipas proceseve të zbatimit të teknologjisë informative mund të krijohen pas aplikimit dhe zbatimit të sistemit final.

Fjalët kyçe: Sfidat, mangësitë, sistemi elektronik, etj.

GATISHMËRIA – SFIDAT DHE MANGËSITË

Disa nga komponentët kryesorë për zbatimin prokurimit elektronik në Kosovë tanimë ekzistojnë. Kosova ka një ligj të mirë të prokurimit dhe të nënshkrimeve elektronike, ka rregullime të mira institucionale, shërbimin në përdorim të gjerë të publikimit të prokurimeve elektronike, si dhe vullnet mjaft të lartë politik për këtë reformë. Në nivel dytësor, Kosova gjithashtu ka një infrastrukturë të mirë të telekomunikimeve dhe një rrjet qeveritar mjaft të mirë.

Ndaj një vetëvlerësimi për gatishmëri janë përgjigjur katër agjenci në cilësinë e palëve me interes, i cili është plotësuar me konsultimet e cekura më poshtë dhe me një punëtori për palët me interes. Rezultatet e vlerësimit të gatishmërisë janë përmbledhur në tabelën 1.

Tabela 1 Përmbledhje e vlerësimit të gatishmërisë për e-prokurim

Komponenti kryesor	Vlerësimi 1-4	Komente
Udhëheqja qeveritare	3.5	Aspektet institucionale janë të shëndosha, përkrahja politike duhet të fuqizohet dhe vizioni të artikulohet
Menaxhimi i resurseve njerëzore	2.5	Trajnimi i zyrtarëve dhe i operatorëve ekonomikë, si dhe ka mungesa të bashkërendimit e të përqendrimit
Planifikimi dhe menaxhimi	3	Planifikimi dhe menaxhimi janë të duhur, ka mungesë të vetëbesimit se Departamenti i prokurimit është duke u menaxhuar mirë. Kërkohej reforma e RPB-së për internet
Politika	4	Nevojitet zhvillimi i politikave lidhur me aspektet e internetit, modelit të punës, verifikimit dhe objektivave
Legjislacioni dhe rregulloret	4	Ligji i prokurimit dhe ai i e-nënshkrimit janë të duhur, por janë të dëshirueshme disa amendamente
Infrastruktura dhe shërbimet e internetit	4	Infrastruktura dhe shërbimet e internetit janë të duhura

Standardet	2.5	Mosekzistimi i politikës së efektshme lidhur me kornizën qeveritare të ndërveprueshmërisë
Integrimi i sektorit privat	4	Kapaciteti i shfrytëzuesve nga sektori privat është i duhur, ndërsa kapaciteti i zhvilluesve është pjesërisht i duhur
Sistemet	3	Zhvillimi ekzistues i prokurimit elektronik është i mirë, por ka mungesë të kapacitetit funksional

Çështjet e paraqitura në tabelën 1 tregojnë se gatishmëria e përgjithshme për prokurim elektronik në Kosovë në një nivel mjaft të lartë. Ka nevojë për disa vendime të politikave, dhe gjithashtu duhet të trajtohen çështjet si në vijim.

UDHËHEQJA DHE RREGULLIMET INSTITUCIONALE

Nga pothuajse të gjitha përvojat ndërkombëtare del se elementi thelbësor për zbatimin e prokurimit elektronik është udhëheqja e qeverisë, duke përfshirë miratimin e strategjisë së prokurimit elektronik nga qeveria, vizionin dhe objektivat shtetërore për prokurim elektronik, si dhe autorizimin dhe furnizimin me resurse të agjencisë kryesore zbatuese, e cila do të drejtonte ndryshimet e nevojshme.

Në Kosovë ekziston kërkesë mjaft e madhe për zhvillimin e prokurimit elektronik nga operatorët ekonomikë dhe burokracia: mungesa e transparencës dhe korrupsioni perceptohen si çështje kryesore që ndikojnë në klimën e investimeve në vend. Është e qartë se kjo nismë ka përkrahje politike, megjithatë kjo nuk duket se është artikuluar në asnjë deklaratë publike.

Roli i entitetit udhëheqës është thelbësor: ky entitet grumbullon ekspertizën teknike, si dhe organizon bashkërendimin e bashkëpunimin brenda sektorit qeveritar. Rekomandohet që sistemi të ofrohet në nivel qendror dhe që të ketë një infrastrukturë të përbashkët e unike të teknologjisë informative. Zhvillimet e ndara të e-prokurimit brenda ministrive apo departamenteve veç e veç do të copëzonin mundësitë dhe nuk duhet të pranohen. Zhvillimi i copëzuar ngritë rreziqe që sistemet të mos jenë të ndërveprueshme apo të mos kenë të dhëna të përbashkëta bazike, të cilat do të mundësonin vlerësimin e duhur të performances dhe integrimin financiar. Copëzimi gjithashtu do të rriste rreziqet e sigurisë.

Po ashtu ekziston nevoja për të pasur kapacitete në rregullimin e grupeve punuese/komisioneve ndërdepartamentale me qëllim të zhvillimit të aspekteve të ndryshme, siç është ai i ristrukturimit të procesit të punës. Përfshirja e pushtetit lokal duhet të konsiderohet si optimale dhe është e rekomandueshme. Kjo nuk nënkupton se rregulloret, politikat, procedurat apo dokumentet e pushtetit lokal duhet të jenë të njëjta me ato të ministrive.

KRRPP-ja është agjenci udhëheqëse dhe ka rol bashkërendues. KRRPP-ja ka autoritetin, rolin institucional, kapacitetin e politikave dhe disa resurse për ta udhëhequr këtë agjendë. Ky është një zhvillim pozitiv duke marrë parasysh rolin strategjik ndërqeveritar të atij entiteti në procesin e prokurimit.

Do të ishte e dëshirueshme që kjo të konsolidohet edhe me një deklaratë publike të kryeministrit⁴⁵¹ ose të kabinetit qeveritar, dhe të përcaktohet prokurimi elektronik si program prioritar me objektivat që:

- Të sigurojë transparencë për të gjitha palët me interes;
- Të zvogëlojë burokracinë dhe të përmirësojë efikasitetin për të gjitha palët me interes;
- Të fuqizojë besimin në punët e qeverisë dhe të përmirësojë klimën e investimeve në vend;
- Të mandatojë kornizë të gjerë të prokurimit elektronik, duke përfshirë një sistem të integruar;
- Të zbatojë politikat operacionale dhe sisteme të prokurimit elektronik.

Rekomandohet që programi të përfshinë të gjitha entitetet qeveritare dhe të gjitha nivelet e qeverisë. Kosova në këtë aspekt ka përparësi mjaft të madhe – është jashtëzakonisht e rrallë që të gjitha entitetet dhe nivelet e tilla të qeverisë të jenë të përfshira nën një autoritet të vetëm rregullativ.

Derisa KRRPP-ja është përgjegjëse për ndërmarrjen e këtyre aspekteve të politikave dhe për zbatimin e programit, ekziston edhe konflikti i mundshëm i roleve për KRRPP-në, i cili duhet të menaxhohet: sipas Ligjit të prokurimit, roli i KRRPP-së kryesisht ka të bëjë me mbikëqyrjen, rregullimin dhe specifikimin e praktikave më të mira dhe të kërkesave për kapacitete, dhe në parim duhet të ketë rol minimal në fushën kontraktuale dhe operacionale. Rolet operacionale zakonisht duhet t'u përkasin entiteteve të prokurimit, dhe duhet të rregullohen e të monitorohen nga KRRPP-ja dhe entitetet e tjera mbikëqyrëse.

Ligji i prokurimit ka tensione / konflikte të roleve, për shembull, KRRPP-ja është përgjegjëse për monitorimin e përputhshmërisë dhe për zbatimin e prokurimit (siç ceket në nenin 81, par. 3, monitorimi i menaxhimit të kontratave nga entitetet e prokurimit). Nga ana tjetër, KRRPP-ja ka mandat domethënës për të realizuar zhvillimin e prokurimit elektronik në ligj (neni 87 parasheh që KRRPP-ja të përkrahë zhvillimin e

⁴⁵¹ Një autoritet i vetëm ministror është i pamjaftueshëm. Programi i prokurimit përfaqëson strategjinë e përgjithshme qeveritare, e cila ndërtohet me të gjitha resorët e ministrive.

prokurimit elektronik), ku përfshihen shpenzime, dhe rrjedhimisht krijohen fërkime me rolet e tij të monitorimit të prokurimit dhe ato rregullativ.

Sa i përket funksionit të udhëheqjes, agjencia kryesore për sistemin e e-prokurimit duhet të jetë në gjendje të udhëheq reformën, politikën e prokurimit dhe të drejtojë zhvillimin e Riinxhinierimit të Procesit të Punës (RPP) dhe të metodave të reja të prokurimit që mundësohen përmes e-prokurimit. KRRPP-ja gjithashtu qe disa vite është duke menaxhuar dhe zhvilluar faqen ekzistuese të internetit, e cila duket të jetë nisma e vetme dhe më e suksesshme e e-qeverisjes deri më tani në Kosovë.

Roli i udhëheqjes është i nevojshëm dhe rekomandohet që KRRPP-ja të mban rolin udhëheqës për zhvillim. Konflikti potencial i roleve nuk konsiderohet të jetë çështje kritike, dhe ka disa përjashtime të ngjashme në vendet e tjera të botës që janë të suksesshme dhe vazhdojnë të jenë të tilla.

Gjithashtu, sa i përket udhëheqjes së qeverisë, duket se ajo është fuqimisht e përkushtuar dhe ka modernizuar edhe legjislacionin përkatës, por gjithashtu është e dëshirueshme dhe rekomandohet që qeveria publikisht të demonstroi vendosmërinë e saj, dhe që të përcaktojë një afat kohor për operacionalizimin e sistemit të e-prokurimit. Gjithashtu, duhet të përcaktohen rezultatet kryesore të performansës nga kjo politikë, siç janë bie fjala kursimet dhe transparenca.

BURIMET NJERËZORE

Ekziston nivel i ulët i vetëdijesimit për nevojat e trajnimit, ndërsa pronësia e strategjisë së trajnimit ende nuk është e përcaktuar. Në përvojat e shumicës së vendeve, trajnimi është element thelbësor i zbatimit të prokurimit elektronik, si për nivelet e ndryshme të qeverisë, ashtu edhe për sektorin privat. Megjithatë, si sektori publik, ashtu edhe ai privat kanë shkallë të lartë të njohurive të internetit, andaj konsiderohet se kjo nuk do të jetë një problem i madh. Sido që të jetë, ky aspekt mbetet për t'u trajtuar më tej në planin e zbatimit.

PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI

Planifikimi dhe menaxhimi i prokurimit udhëhiqen përmes legjislacionit konsistent, ku përfshihet pushteti lokal, dokumentet standarde dhe proceset standarde, të cilat vlejné në përgjithësi. Këto karakteristika do ta bëjnë RPP për prokurim elektronik relativisht një proces të efektshëm. Po ashtu, ekziston përkrahje e gjerë e përmirësimeve të vazhdueshme në procesin e prokurimit elektronik. Nga ana tjetër, ekziston një bindje më e vogël se proceset e prokurimit janë mirë të menaxhuara tek entitete blerëse, dhe ka analiza të pakta për shpenzimet e qeverisë si tërësi. Prokurimi më shumë shikohet në aspektin e procesit të përputhshmërisë sesa në atë të menaxhimit të performansës.

Burimi: Strategjia për qeverisjen elektronike 2009-2015

Prokurimi elektronik

Edhe pse diçka ka filluar të bëhet në këtë fushë, finalizimi i kësaj pune mbetet objektiv. Prokurimi elektronik nuk nënkupton vetëm publikimin e rezultateve të prokurimit, por tërë procesin, ashtu siç parashihet në Ligin e prokurimit. Të gjitha kërkesat e prokurimit mund të publikohen përmes internetit. Sistemi për menaxhimin e prokurimit mundëson ruajtjen elektronike, si dhe vlerësimin teknik e financiar të ofertave. Paraqitja e këtij procesi në mënyrë transparente përmirëson besimin dhe efikasitetin. Duke u bazuar në të drejtat, ashtu siç parashihet me ligj, sistemi i menaxhimit të procesit ia mundëson çdo pale që të përcjellë procesin dhe të ankohet përmes internetit. Zbatimi i prokurimit elektronik ndikon në eliminimin e pengesave të pranishme më parë, duke rritur kështu besimin e të gjitha palëve të përfshira. Qasja do t'u jepet të gjithë personave, nëse rast se e njëjta lejohet me ligj, ndërsa në rast të kufizimeve, ata duhet të përdorin identifikimin elektronik (e-id). Çdo kategori do të ketë kontrollin e veçantë të qasjes, duke përfshirë autoritetin kontraktues, kontraktin, ofertuesit, ankuesit, autorizuesit e njësive buxhetore, auditorët dhe kategoritë e tjera të përcaktuara sipas ligjit në fuqi. Siguria e informatave në prokurim elektronik do të jetë maksimale. Oasja në prokurim

Nuk ekziston një strategji e prokurimit elektronik, përveç një deklarate në paragrafin 3.1.7 (shih kutinë) të një funksionaliteti të kufizuar në Strategjinë për qeverisjen elektronike (2008 – e cila është duke u përditësuar). Kjo nuk paraqet strategjinë e prokurimit elektronik, dhe asnjë strukturë institucionale nuk është propozuar për të udhëhequr një program të tillë. Në këtë rast, vizioni dhe objektivat nuk janë artikuluar, dhe fushëveprimi i e-prokurimit nuk është kuptuar mirë nga disa palë kryesore me interes, ku edhe agjencia udhëheqëse (KRRPP) nuk ka kuptuar mirë aspektet e saj kryesore. Gjithashtu, menaxhimi i rrezikut nuk është i konsoliduar kur kemi të bëjmë me projektet e mëdha të prokurimit (prokurimi elektronik është projekt madhor), ndërsa menaxhimi dhe kontrolli i të dhënave ka nevojë për fuqizim. Të gjitha këto aspekte do të trajtohen në strategjinë e prokurimit elektronik.

POLITIKA

Politika e prokurimit e qeverisë është mjaft mbështetëse dhe në përputhje me objektivat e prokurimit elektronik. Objektivat e qeverisë lidhur me prokurimin përfshijnë qeverisjen e mirë, efikasitetin dhe zhvillimin ekonomik. Megjithatë, ky vizion nuk është artikuluar publikisht, andaj kjo duhet të trajtohet. Njashtu, nuk është e qartë se deri në çfarë mase entitetet blerëse menaxhojnë me rregulloret e prokurimit – ekziston perceptimi se korrupsioni është problem i madh. Po ashtu, është me rëndësi të thuhet se ka dëshmi se auditimi merret me prokurimin vetëm nga aspekti i përputhshmërisë ligjore, por jo edhe aq shumë me çështjen se menaxhimi dhe kontrolli i të dhënave aktualisht nuk është i duhur dhe nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar këto shqetësime. Funkzioni i aludimit duhet t'u përket palëve kryesore me interes në fushën e e-prokurimit dhe duhet të jetë në gjendje t'i kontribuojë kornizës së politikave lidhur me atë se çfarë kapacitetesh të informimit do të krijohen. Lidhur me e-prokurimin do të ketë nevojë për një numër politikash, të cilat duhet të hartohen nga KRRPP-ja për qëllime të funksionimit të sistemit. Këto politika janë të përvijuara në planin e zbatimit. Po kështu, ekzistojnë instrumentet e prokurimit elektronik, posaçërisht marrëveshjet kornizë, të cilat do të duhet të zhvillohen nga CPA, dhe të cilat gjithashtu do të kërkojnë zhvillim të politikave, të cilat do të mund të futeshin në përdorim brenda një afati të shkurtër. Këto çështje shtjellohen edhe në planin e zbatimit.

CENTRALIZIMI KUNDREJT DECENTRALIZIMIT

Rekomandohet që strategjia e prokurimit elektronik të parasheh një sistem të vetëm për të gjitha entitetet qeveritare dhe nivelet e qeverisë. Në këtë mënyrë teknologjia shfrytëzohet më mirë dhe në veçanti minimizohet duplikimi i menaxhimit të sigurisë, menaxhimi i katalogut, duplikimi i regjistrave të furnitorëve, etj, ku edhe aspektet e ndërveprueshmërisë janë më stabil. Ky sistem gjithashtu siguron një regjistrim të vetëm të furnitorëve dhe, rrjedhimisht, efikasitet më të madh të tyre, si dhe përmirëson perspektivën e metodologjive alternative të prokurimit, siç janë marrëveshjet kornizë. Nganjëherë kjo kuptohet si centralizim i prokurimit, por kjo nuk është kështu. Centralizimi përfaqëson një infrastrukturë të unifikuar të informatave të prokurimit e jo centralizim të vet prokurimit. Entitetet dhe nivelet e qeverisë mund të mbeten plotësisht përgjegjëse dhe të mbajnë nën kontroll se çka blejnë dhe kur e blejnë – prokurimi mbetet i decentralizuar, por shfrytëzon infrastrukturën e përbashkët, mu sikurse shfrytëzon infrastrukturën e tjera të përbashkëta të shtetit për tregti, siç janë ligjet e prokurimit dhe sistemet bankare të shtetit. Në disa raste ekzistojnë dispozita për ministrinë apo nivelet e caktuara të qeverisë për të pasur mundësinë e individualizimit të sistemit unik për qëllime të tyre të menaxhimit, pa sakrifikuar aspektet e përbashkëta, por kjo nuk rekomandohet.

POLITIKA SHETËRORE DHE ARGUMENTET NË FAVOR TË PROKURIMIT ELEKTRONIK

Strategjia e prokurimit elektronik duhet të jetë në përputhje me kornizën shtetërore të politikave, duke përfshirë për shembull politikën e qeverisjes dhe politikën financiare. Nuk do të ishte e mundur të vërtetohet nëse strategjia e e-prokurimit është në përputhje me politikën financiare pa dhënë argumentet në favor të prokurimit elektronik që duhet të jenë pjesë e zhvillimit të planit strategjik. Një propozim i argumenteve në favor të prokurimit elektronik është paraqitur në shtojcën 3. Politikën e tjera shtetërore, siç është ajo e sigurisë dhe kontrollit të dhënave shtetërore po ashtu duhet të zbatohen. Këto nuk janë thjeshtë çështje të menaxhimit dhe të teknologjisë, por më shumë janë çështje të politikës, të cilat do të shtjellohen më poshtë.

LEGJISLACIONI

Legjislacioni ekzistues i Kosovës për prokurim dhe tregti elektronike është mjaft përkrahës për fushën e prokurimit elektronik, pavarësisht disa çështjeve që duhet të ndryshohen, siç është nënvizuar në pjesët e mëposhtme të këtij raporti. Përmes Ligjit bazë të prokurimit shprehimisht njihet dhe ofrohet prokurimi elektronik, si dhe disa nga metodologjitë e prokurimit në internet, siç janë ankandet e anasjella, si dhe autoritetet, siç është KRRPP-ja, që rregullojnë këto metoda. Neni 129, paragrafi 4 është kundërthënës – qeveria deklaron se prokurimi elektronik është më i miri në aspektin e transparencës dhe qeverisjes, por zbatimin e tij e parasheh të jetë vetëm zgjedhor. Kjo dispozitë nuk i bën mirë as pushtetit lokal e as atij qendror. Në BE disa aspekte të prokurimit janë të ndaluara, përveç nëse bëhen përmes internetit (Direktiva e prokurimit 2004/18/EC; neni 1.6). Gjithashtu, mund të theksohet se faktori kryesor i suksesit të madh të programit portugez të prokurimit elektronik ishte se ka qenë obligues.

Në legjislacion nuk parashihen ndryshime të kontratave. Kjo do të kufizon disa nga kapacitetet e menaxhimit të prokurimit elektronik dhe po ashtu ka gjasa të zvogëlojë vlerën e disa projekteve të ndërlikuara qeveritare të prokurimit. Nuk është reale të pritët që planifikimi i projekteve komplekse mund të parasheh çdo aspekt dhe ku është i pamundur ndryshimi i marrëveshjeve kontraktuale, andaj OE-të në çmimet e tyre të ofertimit duhet të faktorizojnë një pasiguri më të madhe të çmimeve. Është e paqartë nëse ky aspekt i

legjislacioni gjithashtu do të pengojë zhvillimin e disa formave të marrëveshjeve kornizë, të cilat janë veçanërisht të efektshme në prokurim elektronik.

Përveç asaj që u cek më lartë, kushtet bazë legislative për prokurim elektronik dhe tregti elektronike në përgjithësi janë të thjeshta që të kenë status juridik, me kusht që:

- Të ketë dokumente elektronike dhe
- Nënshkrime elektronike.

Legjislacioni për nënshkrime elektronike (Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit, 2012) aktualisht parasheh këtë. Legjislacioni për nënshkrime elektronik është i llojit hibrid, ku përfshihen referencat në teknologji, por duke paraparë edhe neutralitet të plotë teknologjik. Ligji shkon përtej disa dispozitave më kufizuese të Ligjit të prokurimit, të cilat kanë natyrë kufizuese ndaj përdorimit të dokumenteve elektronike. KRrPP-në tanimë është e autorizuar që të hartojë rregullore për zbatimin e prokurimit elektronik.

Kushtet e tjera procedurale për prokurim elektronik përfshijnë rregulloret dhe politikat për t'u siguruar:

- Që zbatimi dhe njohja e prokurimit elektronik të jetë në nivel të njëjtë me prokurimin manual;
- Që të obligohet përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik nëpër agjenci sipas planit favor. Rekomandohet që të mos lejohet ofertimi paralel (përdorimi i formularëve manual dhe elektronik) përtej një periudhe të shkurtër të përkohshme;
- Që të ndryshohen kushtet e dokumenteve të ofertimit kurdo që kjo është e nevojshme për t'iu përshtatur prokurimit elektronik;
- Që të pranohen metodologjitë e prokurimit përmes internetit, siç janë ankandet elektronike;
- Që të obligohet regjistrimi i furnitorëve përmes internetit si parakusht për pjesëmarrjen në prokurimet qeveritare përmes sistemit të prokurimit elektronik, si dhe dorëzimi i përgjigjeve për ofertat përmes sistemit të prokurimit elektronik;

Në kuadër të kushteve themelore lidhur me dokumentet elektronike dhe nënshkrimet elektronike, nganjëherë identifikohen edhe një numër reformash të tjera legislative, duke përfshirë edhe ato për fushat në vijim:

- Menaxhimi elektronik i arkivave;
- Mbrojtja dhe privatësia e konsumatorit;
- Ligjet për dëshmitë ligjore;
- Mbrojtja dhe besueshmëria e të dhënave;
- Prona intelektuale dhe e drejta e autorit;
- Kodet e praktikës së mirë.

Megjithatë, këto fusha në përgjithësi nuk janë parakushte për zbatimin e prokurimit elektronik. Thënë në përgjithësi, legjislacioni ekzistues kryesisht mund të lehtësojë prokurimin elektronik.

INFRASTRUKTURA

Kosova ka një mbulueshmëri të mirë të infrastrukturës së telekomunikacionit, e cila përfshinë pothuajse të gjitha zonat e vendit, duke përfshirë të gjitha pushtetet lokale. Rrjeti qeveritar është i pajisur me kapacitete të caktuara të ruajtjes dhe të nxjerrjes së informatave në rast të fatkeqësive dhe ka edhe një tepricë, ndërsa investimet e mëtejme në qendrën e të dhënave janë në vazhdim e sipër. Ministria e Administratës Publike ofron dhe udhëzime lidhur me standardet e ndërveprueshmërisë dhe me menaxhimin e rrezikut në fushën e zhvillimit të aplikacioneve. Fakti se a ka qendra ekzistuese e të dhënave kapacitete të mjaftueshme për prokurim elektronik duhet të vlerësohet përmes specifikacioneve të sistemit, të dhëna në kuadër të këtij projekti.

STANDARDET

Infrastruktura e telekomunikimeve kryesisht ka rëndësi dytësore për prokurim elektronik. Në shumë vende prokurimi elektronik funksionon me mbulueshmëri dhe shpejtësi të ulët të lidhjes. Në shumë raste, aplikacionit janë të parapara të funksionojnë edhe me telefona mobilë apo përmes kafeve të internetit.

Një rëndësi më të madhe se rrjeti i telekomunikacionit kanë standardet e ndërveprueshmërisë dhe midëlluerit. Disa entitete publike në Kosovë konsiderojnë se nuk ka kornizë të artikuluar mirë të ndërveprueshmërisë, kështu që nuk ka standarde të qarta për zhvillimin e sistemeve apo për blerjen e harduerit, ku mund të themi se kanë dalë në sipërfaqe të ashtuquajturit ishuj të mospërputhshmërisë. Pavarësisht kësaj, rrjeti është dobët i integruar në praktikën qeveritare të menaxhimit, ky pasqyrohet mungesa efektive e GIF-it. Simptomatike për këtë është shfrytëzimi i përbashkët i adresave të punës në mes të zyrtarëve qeveritarë në faqet e internetit, siç janë: Hotmail/Gmail/yahoo. MAP-ja është këshilluar që të 'inkurajojë' zhvillimin e aplikacioneve dhe përputhjen e tyre me Arkitekturën e Orientuar në Shërbime (AOSh), si dhe që entiteti përkatës të mbajë pronësinë ndaj kodit. Strategjia ekzistuese e qeverisjes elektronike nuk japë udhëzime të qarta për këtë çështje të rëndësishme:

3.5 Hardueri dhe softueri

Paralelisht me përmirësimin e teknologjisë dhe zgjerimin e qeverisjes elektronike duhet të ketë qasje për çështjet e harduerit dhe të softuerit përmes amandamentimit të ligjeve të nevojshme dhe investimit në teknologjitë e reja të harduerit dhe të softuerit.

Platformat ekzistuese do të përmirësohen, zgjerohen, kapaciteti i harduerit do të shtohet dhe platformat e reja do të zbatohen me qëllim të arritjes së një qeverisje elektronike të suksesshme.

Softueri do ta ketë Arkitekturën e Orientuar drejt Shërbimit (AOSh) dhe shërbimet e rrjetit të internetit (i mbështetur nga protokollet siç janë XML, SOAP, WSDL, WDDX, dhe UDDI); Web 2.0 me qëllim të ofrimit të ndërveprueshmërisë dhe përkrahjes. Teknologjia që do të përdoret në të ardhmen kryesisht do të përqendrohet në hapësirën kibernetike.

Gjithashtu do të bëhen përpjekje për marrjen e licencave të softuerit; do të bëhen investime të nevojshme dhe do të zbatohen aplikacionet me qëllim të krijimit të një sistemi funksional të qeverisjes elektronike.

Nuk është e qartë se a është komunikuar apo udhëhequr në mënyrë të efektshme dhe me autoritet dhe po ashtu edhe mospërrputshmëria ka qenë problematike, e cila është përcjellë me probleme të kapacitetit të TI-së në shumë entitete. Në disa vende, shpenzimet e TI-së nuk janë të lejuara pa lejen e agjencisë udhëheqëse të TI-së me qëllim të konsistencës së shpenzimeve të propozuara në GIF-in qeveritar dhe me strukturën e politikave.

Sistemi i e-prokurimit i specifikuar në këtë projekt do të jetë në përputhje me Kornizën mbarë evropiane të ndërveprueshmërisë dhe me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, ky sistem do të jetë i bazuar në Arkitekturën e Orientuar në Shërbime (AOSh), e cila është po ashtu në përputhje me politikat MAP-së.

Gjithashtu duhet të theksohet se prokurimi përmes faqes qendrore të internetit automatikisht do të mund të tërhiqte kontrollin e politikave për të siguruar që proceset e blerjes të jenë në përputhje me të gjitha politikat e qeverisë. Këto politika në vendet e tjera përfshijnë ekonomizimin e energjisë, preferencat e bizneseve të vogla, etj. Nganjëherë ekziston politika e teknologjisë, përmes së cilës parashihet që blerjet në fushën e TI-së të jenë në përputhje me politikat e arkitekturës qeveritare. Sistemi i prokurimit elektronik do të jetë në gjende të përfshijë verifikuesin e listës kontrolluese të politikave. KRRPP-ja duhet të përfshinë Instrumentin e përputhshmërisë së politikave në arkitekturën e prokurimit elektronik.

SEKTORI PRIVAT

Sektori privat është mirë i përshtatur në tregtinë elektronik, duke përfshirë punët bankare përmes internetit. Është sugjeruar se do të ketë nevojë për trajnime të sektorit të biznesit për fushën e prokurimit elektronik, por se kjo nuk pritet të jetë detyrë kryesore. Konsiderohet që sistemi i prokurimit elektronik do të zvogëlojë gabimet e Operatorëve Ekonomikë (OE) dhe mund të pritet që të rrisë nivelin e konkurrencës së efektshme. Kjo kompetencë vlen për të gjitha bizneset, pos për ato shumë të vogla. Në përgjithësi duket se ka gjasa që kjo nismë do të ketë përkrahje të madhe nga shumica e palëve në sektorin e biznesit. E vetmja rezervë mund të jetë fakti se mund të ketë rezistencë që rrjedh nga besueshmëria e sistemit nga aspekti i sigurisë, ku disa OE mund të frikësohen se operatorët qeveritarë mund të shkyçin nivelet e sigurisë për të pasur qasje jo të duhur në dokumentet e ofertimit. Kjo çështje ka dalë në pah në një rast në Indi, dhe do të trajtohen në pjesët e mëposhtme të raportit.

LITERATURA

- [1] Besnik Hajdari, “ Punimi i Doktoratës – Domsodoshmëria e prokurimit elektronik në Republikën e Kosovës – Mundësitë dhe Sfidat”, UET, Nëntor 2017
- [2] Edmond Beqiri, “ Interneti – komunikimet kompjuterike”, Dukagjini, Pejë, 2000
- [3] Doracak për ECDL (European Driving Licence), Smart Bits, Prishtinë, shtator 2005
- [4] Legjislacionet e prokurimit publik – Kuvendi i Republikës së Kosovës